

Shkodër, më ____ . ____ .2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTII I PROCEDURËS: Hartimi i projekteve për rikonstruksionin e objekteve civile, veprave të artit dhe infrastrukturës rrugore, i ndarë në lote si më poshtë:

Loti 1: Projektim i objektit: Ndërtim Objekt Magazinë në funksion të Bashkisë Shkodër.

Loti2: Projektim i objektit: Ndërhyrje Emergjente në rritjen e sigurisë për urën Bardhaj.

Loti3: Projektim i objektit: Ndërtim i mbështetëseve bregore (shpatullave) dhe mbështetëses së ndërmjetme të Urës së fshatit Kir dhe urës së Mgullës.

Loti 4: Projektim i objektit: Rikonstruksion Rruga e Bregu i Detit Velipojë (faza II)

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi CPV: 71322300-4 - Shërbime për projektim urash, 71221000-3 - Shërbim për projektim ndertesash, 22114311-5 - Projekte

VLERA E FONDIT LIMIT prej 4,669,677.75 Lekë (Katër milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e shtatë pike shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, i ndarë si më poshtë:

Loti 1: Projektim për objektin “Magazinë në funksion të Bashkisë Shkodër
me fond limit prej **1,513,367.15** (Një milion e pesëqind e trembëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë pesëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH.

Loti 2: Projektim për objektin Ndërhyrje Emergjente në rritjen e sigurisë për urën Bardhaj me fond limit prej **1,726,608.00** (Një milion e shtatëqind e njëzet e gjashtë mijë e gjashtëqind e tetë) lekë pa TVSH.

Loti 3: Projektim për objektin i mbështetëseve bregore (shpatullave) dhe mbështetëses së ndërmjetme të Urës së fshatit Kir dhe urës së Mgullës me fond limit prej **827,294.29** (Tetëqind e njëzet e shtatë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e katër pikë njëzet e nëntë) lekë pa TVSH.

Loti 4: Projektim për objektin Rikonstruksion Rruga e Bregu i Detit Velipojë faza II me fond limit prej **602,408.31** (Gjashtëqind e dy mijë e katërqind e tetë pikë tridhjetë e një) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Shkodër** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*”.

Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

AK ka mbajtur në konsideratë parashikimet e pikës 3, të nenit 42, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, ku përcaktohet: “Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë **kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot**. Kërkesat duhet të jenë **në përpjesëtim** dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe **vlerën e lotit**”, pikës 9, të po këtij neni, ku parashikohet: “Në çdo rast, **lotet janë të organizuara si procedura të veçanta brenda një procedure**. Fillimi dhe përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër të procedurës”

Loti 1: Projektim i objektit: Ndërtim Objekt Magazinë në funksion të Bashkisë Shkodër

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit e konkretisht **605,346.86** (Gjashtëqind e pesë mijë e treqind e katërdhjetë e gjashtë pikë tetëdhjetë e gjashtë) lekë.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" "Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën".

"Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.", si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/c, nenin 47 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar
"Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:
c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe në kontratat me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedurë prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohe dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **605,346.86** (Gjashtëqind e pesë mijë e treqind e katërdhjetë e gjashtë pikë tetëdhjetë e gjashtë) lekë., që është 40% e vlerës së fondit limit lotit dhe vendosja e këtij limiti nuk kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomike.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata” si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 55, pika 4, “Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës/lotit, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”. Referuar parashikimeve ligjore të nenit 43, pika 2, germa c), për procedurat nën kufirin e ulët monetar, siç është rasti i kësaj procedure.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për vitin 2025 (Sipas QKB) si dhe këstet e maturuara për vitin 2026 sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetdeklarimet në formularin përmbledhës të vetdeklarimit, siç kërkohet në pikën 2.2.2, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose kopje të njësuar me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr. 131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht **302,673.4 (Treqind e dy mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre pikë katër) lekë.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku të shënohen datat, shumat dhe **shërbimeve** të realizuara.
- b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 "Kërkesat për kualifikim", të Ligjit Nr 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar pika 4 "ne lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomike zoterojnë burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomike të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontrata e zbatuara në të shkuarën" dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbime të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të shërbimit të kërkuar objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë realizuar kontrata të

ngjashme, te jete afer limitit maksimal te lejuar dhe ne kete menyre, AK ka sigurine dhe besueshmerine qe OE ofertues mund te realizoje kontraten objekt prokurimi pa patur pengesa te ndryshme qe do te ndikonin ne ecurine e punes se AK.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Vlera e kerkuar nuk sjell kufizim te konkurrences dhe eshte ne masen 20% te fondit limit.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT) ku të përfshihen kategorite:

2) Projektues arkitekt

a- (objekte industriale)

3) Projektues konstruktor

a- (Objekte civile- industriale-turistike....).

4) Projektues instalator

a-(Projektim te instalimeve te hidro-termosanitare)

b-(Projektim te instalimeve termoteknik-kondicionim....)

c-(Projektim te linjave e rrjeteve elektrike).

f-(Projektim te sistemeve kundra zjarri)

j-(Projektim te rrjeteve CCTV)

5) Projektues Vepra Hidraulike

c-(Ujësjetel kanalizime urbane rurale)

8) Projektues gjeodet

a- (Rilevime inxhinierike)

Shënim: Në lidhje me vlefshmërinë e licencave ekzistuese dhe përshtatjen e kategorive me përshkrimet përkatëse, ofertuesit të mbajnë parasysh VKM-në Nr. 759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në Nr. 943, datë 28.12.2016.

(Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Autoritetit kompetent në Republikën e Shqipërisë, konform VKM-së Nr. 759, datë 12.11.2014, i ndryshuar me VKM-në Nr. 943, datë 28.12.2016).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar , në nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe *vendimin*

nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente duke u bazuar ne kerkesat specifike te percaktuara ne termat e references.

Bazuar në objektivat e projektit dhe komponentët kryesorë të tij janë përcaktuar kategoritë e mësipërme të licensës së projektimit të Operatorit Ekonomik të cilat janë të domosdoshme për hartimin e projektit dhe përputhen me natyrën e shërbimit dhe sipas deryres se projektimit.

*Autoriteti Kontraktor per vendosjen e ketyre licensave eshte bazuar në **Detyrën e Projektimit**, i cili do të përmbajë:*

Projektuesi duhet të ketë parasysh dhe të trajtojë: - Infrastrukturën rrugore - Sistemin kanalizimeve të ujërave të zeza - Sistemin kanalizimeve të ujërave të bardha - Rrjetin e ujësjellësit - Sistemin e ndriçimit rrugor - Rrjetin e furnizimit me energji elektrike dhe rrjetin e telekomunikacionit (nuk parashikohet ndërhyrje) - Rrjetin e sinjalistikë.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet te paraqese Licencat profesionale te stafit kryesor përgjegjës për zbatimin e kontratës ne kategorite si me poshte shenuar, shoqeruar patjeter me cv dhe kontratat individuale te punes (të vlefshme):

2) Projektues arkitekt

a- (objekte industriale)

3) Projektues konstruktor

a- (Objekte civile- industriale-turistike....).

4) Projektues instalator

a-(Projektim te instalimeve te hidro-termosanitare)

b-(Projektim te instalimeve termoteknik-kondicionim....)

c-(Projektim te linjave e rrjeteve elektrike).

f-(Projektim te sistemeve kundra zjarri)

j-(Projektim te rrjeteve CCTV)

5) Projektues Vepra Hidraulike

c-(Ujësjelles kanalizime urbane rurale)

8) Projektues gjeodet

a- (Rilevime inxhinierike)

1 (një) punonjës të pajisur me certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis pasi për këtë objekt nevojitet hartimi i VNM prandaj kërkohej që në staf të jete një punonjës i certifikuar për hartimin e VNM.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 10 të DST. Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK ,dokumentat provuese për vetdeklarimet në formularin përmbledhës të vetdeklarimit ,sic kërkohej në pikën 2.3.3, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose kopje të njësuar me origjinalin.

Argumentimi: Këto kërkesa për stafin janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ”b” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Vendosja e këtij kriteri për stafin është bërë në përputhje me kërkesat e shprehura në termat e referencës.

Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

- Arkitekti, roli i tij është kryesor dhe i përmbahet kërkesave të VKM 408 ‘Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit’ ku si kriter kryesor është realizimi i projektit arkitektural për miratimin e lejes së zhvillimit dhe ndërtimit në përputhje me kërkesat ligjore në projektimin e godinave. Arkitekti përcakton kapacitetin dhe funksionin e ambjenteve, hartimin e planimetrive, prerjeve, fasadave dhe detajeve, pamjeve 3dimensionale dhe përcaktimin e materialeve sipas standardeve dhe performancës së tyre.
-
- **Ing elektrik** nevojitet të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me gjendjen aktuale të ndriçimit dhe projekti të jetë i realizuar që të arrijë standartin e kërkuar ku parashikohet vendosja e infrastrukturës për rrjetin energjisë elektrike, internetit dhe telefonisë në përputhje me standardin shqiptar.
- **Inxhinier ndërtimi**
I cili është i nevojshëm për hartimin e projektit të zbatimit dhe relacionit përkatës sipas përcaktimeve në detyrën e projektimit si dhe në mbështetje të pikës 1 të nenit 15 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” e ndryshuar, në të cilin është parashikuar dokumentacioni për pajisje me leje ndërtimi.
- **Ing topograf** konsiderohet i nevojshëm pasi projekti duhet të përmbajë të gjithë informacionin e rëndësishëm topografik I cili nevojitet gjatë fazës së hartimit të projektit të zbatimit. Projekti duhet të përmbajë kuotat e rrugës distancën e vendosjes së shtyllave etjtopografinë e gjendjes ekzistuese për zonën që zbatohet projekti në të

cilën janë të azhornuara të gjitha ndërtimet në gjendjen e sotme (me leje dhe pa leje) me Koordinata dhe përmasat përkatëse

- Inxhinier hidroteknik

Konsiderohet i nevojshëm pasi në detyrën e projektimit janë përcaktuar detyrat dhe qëllimi për realizimin e projektit të zbatimit ku përfshihet azhornimi në terren i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza, ujësjellësit në mënyrë që të shmangen dëmtimet e mundshme të tij gjatë punimeve të tjera. Të projektohet rrjeti i KUB ne varësi te reshjeve te zonës dhe te jepet zgjidhja optimale sipas manualit Teknik.

- Inxhinieri mekanik

Konsiderohet i nevojshëm pasi në detyrën e projektimit janë përcaktuar detyrat dhe qëllimi për realizimin e projektit të zbatimit. Projektuesi nevojitet për hartimin e projektit të zbatimit të sistemit të ngrohjes dhe sistemit të mbrojtjes kundër zjarrit.

- 1 (një) punonjës të pajisur me certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis pasi për këtë objekt nevojitet hartimi i VNM prandaj kërkohet që në staf të jetë një punonjës i certifikuar për hartimin e VNM.

*Autoriteti Kontraktor për vendosjen e këtyre licensave është bazuar në **Detyrën e Projektimit**, , i cili do të përmbajë:*

Projektuesi duhet të ketë parasysh dhe të trajtojë: - Arkitekturen, konstruksionin, rrjetin e furnizimit me energji, rrjetin e ndricimit, furnizimit me ujë, sinjalistikes

Argumentimi: Këto kërkesa për stafin janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ”b” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Vendosja e këtij kriteri për stafin është bërë në përputhje me kërkesat e shprehura në termat e references

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

- Arkitekti , roli i tij është kryesor dhe i përmbahet kërkesave të VKM 408 'Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit' ku si kriter kryesor është realizimi i projektit arkitektonik për miratimin e lejes së zhvillimit dhe ndërtimit në përputhje me kërkesat ligjore në projektimin e godinave. Arkitekti përcakton kapacitetin dhe funksionin e ambjentëve, hartimin e planimetrive, prerjeve, fasadave dhe detajeve, pamjeve 3dimensionale dhe përcaktimin e materialeve sipas standardeve dhe performances së tyre.

-Ing elektrik nevojitet te rishikojte te gjitha informacionin ekzistues lidhur me gjendjen aktuale te ndricimit dhe projekti te jete i realizuar qe te arrije standartin e kerkuar per realizimin e rrjetit elektrik te brenshem dhe te jashtem

-Ing ndertimit nevojitet per verifikimin e gjendjes aktuale te nderhyrjeve ne tarrace, shtresave, rikonstruksionit dhe nderhyrjeve te brenshme dhe te jashtme.

-Ing mekanik nevojitet per realizimin e projektit të ngrohjes dhe të sistemit te mbrojtjes nga zjarri.

2.3.4 Një punësim mesatar i të paktën **7 (shtate)** personave, për muajin e fundit të vërtetuar me;

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve.
- b) Listpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 10 të DST.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetdeklarimet në formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sic kërkohej në pikën 2.3.4, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose kopje të njësuar me origjinalin.

Argumentimi: Këto kërkesa për stafin janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 41, pika 4, gërma "c" të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zërat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është përlogaritur në për zbatimin me sukses të kësaj kontrate

Eshtë kërkuar vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në pikën 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar sipas së cilës: "Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës".

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlogaritur si më poshtë: për përcaktimin e fuqisë punëtore minimale të kërkuar argumentojmë se jemi bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Termave të References. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë, tregojnë besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

2.3.5 Operatorët ekonomikë që paraqesin ofertë duhet të bazohen në njoftimin Nr. 5585 Prot., datë 25.07.2017 të Agjencisë së Prokurimit Publik, "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 354, datë 11.05.2016, 'Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim.'"

Mosrespektimi i bazës ligjore të sipërpërmendur në përgatitjen e ofertës përbën arsye për skualifikim, pasi oferta duhet të jetë brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të

lejuar, sipas nenit 7/1 të VKM nr. 354, datë 11.05.2016, "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim."

Argumentimi: Eshte vendosur kjo kerkese bazuar ne njoftimin me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (pika 1 e seksionit 2.2 të (Kapaciteti ekonomik dhe financiar) si dhe kapacitetet teknike (pika 1 seksionit 2.3 të Kapaciteti teknik), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku.

Argumentimi: Kjo kërkesë vjen mbështetur në përcaktimet e nenit 77, pika 3, të LPP, ku parashikohet: *"...Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë"*, si dhe pikës 8, të nenit 42, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: *"Autoriteti/enti kontraktor **mund** të përcaktojë kërkesat minimale që u kërkohen operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë"*.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

- ❖ **Termat e Referencës janë hartuar në mbështetje të legjislacionit në fuqi në fushën e projektimit dhe ndërtimit, si më poshtë vijon:**

- Ligjit Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar;
- Ligjit Nr. 8402/1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar;
- VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 "Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", e ndryshuar;
- VKM Nr. 628, datë 15.07.2015 "Për Miratimin e Rregullave Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve", si dhe të
- VKM Nr. 9, datë 11.01.2024 "Për miratimin e rregullave për projektet që duhet t'i nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste".

Kërkesat teknike dhe produktet e pritshme të projektimit janë përcaktuar në përputhje me standardet dhe rregullat teknike në fuqi për projektimin e infrastrukturës rrugore, me qëllim garantimin e sigurisë rrugore, funksionalitetit të veprës, cilësisë së projektit dhe përputhshmërisë së tij me procedurat e oponencës teknike.

Loti 2: Projektim i objektit: Ndërhyrje emergjente në rritjen e sigurisë për urën Bardhaj.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, *sipas shtojcës 10*;
- b. Sigurimin e Ofertës, *sipas Shtojcës 3*;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit e konkretisht **690,643.2 (Gjashtëqind e nëntëdhjetë mijë e gjashtëqind e katërdhjetë e tre pikë dy) lekë.**

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetdeklarimet në formularin përmbledhës të vetdeklarimit, siç kërkohet në pikën 2.2.1, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” *“Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”*.

“Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”, si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/c, nenin 47 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe në kontratat me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.*

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohe dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **690,643.2 (Gjashtëqind e nëntëdhjetë mijë e gjashtëqind e katërdhjetë e tre pikë dy) lekë**. që është 40% e vlerës së fondit limit lotit dhe vendosja e këtij limiti nuk kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata” si

dhe Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 55, pika 4, ”Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës/lotit, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”. Referuar parashikimeve ligjore të nenit 43, pika 2, germa c), për procedurat nën kufirin e ulët monetar, siç është rasti i kësaj procedure.

- **Ing topograf** konsiderohet i nevojshëm pasi projekti duhet te permbaje te gjithë informacionin e rendesishem topografik I cili nevojitet gjate fazes se hartimit te projektit te zbatimit. Projekti duhet te permbaje kuotat e rruges distancen e vendosjes se shtyllave etjtopografinë e gjendjes ekzistuese për zonën që zbatohet projekti në të cilën janë të azhornuara të gjitha ndërtimet në gjendjen e sotme (me leje dhe pa leje) me Koordinata dhe përmasat përkatëse

- Inxhinier hidroteknik

Konsiderohet i nevojshëm pasi në detyrën e projektimit janë përcaktuar detyrat dhe qëllimi për realizimin e projektit të zbatimit ku përfshihet azhurnimi në terren i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza, ujësjellësit në mënyrë që të shmangen dëmtimet e mundshme të tij gjatë punimeve të tjera. Të projektohet rrjeti i KUB në varësi të reshjeve të zonës dhe të jepet zgjidhja optimale sipas manualit teknik

-1 (një) punonjës të pajisur me certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis pasi për këtë objekt nevojitet hartimi i VNM prandaj kërkohet që në staf të jete një punonjës i certifikuar për hartimin e VNM.

2.3.4 Një punësim mesatar i të paktën **5 (pesë)** personave, për muajin e fundit të vërtetuar me;

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve
- b) Listpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për për muajin e fundit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 10 të DST.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nënshkrimit të afatëve ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetdeklarimet në formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sic kërkohet në pikën 2.3.4, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose kopje të njësuar me origjinalin.

Argumentimi: Këto kërkesa për stafin janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ”c” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zërat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është përlogaritur në për zbatimin me sukses të kësaj kontrate

Eshtë kërkuar vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në pikën 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” sipas së cilës: ”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurrohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlogaritur si më poshtë: për përcaktimin e fuqisë punëtore minimale të kërkuar argumentojmë se jemi bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Termave të References. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë, tregojnë besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

2.3.5 Operatorët ekonomikë që paraqesin ofertë duhet të bazohen në njoftimin Nr. 5585 Prot., datë 25.07.2017 të Agjencisë së Prokurimit Publik, "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 354, datë 11.05.2016, 'Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim.'"

Mosrespektimi i bazës ligjore të sipërpërmendur në përgatitjen e ofertës përbën arsye për skualifikim, pasi oferta duhet të jetë brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar, sipas nenit 7/1 të VKM nr. 354, datë 11.05.2016, "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim."

Argumentimi: Është vendosur kjo kërkesë bazuar në njoftimin me Nr. 5585 Prot., datë 25.07.2017 të Agjencisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (pika 1 e seksionit 2.2 të (Kapaciteti ekonomik dhe financiar) si dhe kapacitetet teknike (pika 1 seksionit 2.3 të Kapaciteti teknik), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku.

Argumentimi: Kjo kërkesë vjen mbështetur në përcaktimet e nenit 77, pika 3, të LPP, ku parashikohet: "...Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë", si dhe pikës 8, të nenit 42, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: "Autoriteti/enti kontraktor **mund** të përcaktojë kërkesat minimale që u kërkohen operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë".

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të

kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

❖ **Termat e Referencës janë hartuar në mbështetje të legjislacionit në fuqi në fushën e projektimit dhe ndërtimit, si më poshtë vijon:**

- Ligjit Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar;
- Ligjit Nr. 8402/1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar;
- VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 "Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", e ndryshuar;
- VKM Nr. 628, datë 15.07.2015 "Për Miratimin e Rregullave Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve", si dhe të
- VKM Nr. 9, datë 11.01.2024 "Për miratimin e rregullave për projektet që duhet t'i nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste".

Kërkesat teknike dhe produktet e pritshme të projektimit janë përcaktuar në përputhje me standardet dhe rregullat teknike në fuqi për projektimin e infrastrukturës rrugore, me qëllim garantimin e sigurisë rrugore, funksionalitetit të veprës, cilësisë së projektit dhe përputhshmërisë së tij me procedurat e oponencës teknike.

Loti 4: Projektim i objektit: Rikonstruktion Rruga e Bregu i Detit Velipojë faza II

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas shtojcës 10;**
- b. Sigurimin e Ofertës, **sipas Shtojcës 3;**

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **240,963.32 (Dyqind e katërdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tre pikë tridhjetë e dy) lekë.**

Kriteri konsiderohet i permbyshur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të

vetdeklarimit, siç kërkohet në pikën 2.2.1, duke dorëzuar dokumentacionin original ose kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” *“Ne lidhje me situaten ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”*.

“Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”, si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/c, nenin 47 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe në kontratat me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.*

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohe dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **240,963.32 (Dyqind e katërdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tre pikë tridhjetë e dy) lekë**, që është 40% e vlerës së fondit limit lotit dhe vendosja e këtij limiti nuk kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata” si dhe Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 55, pika 4, ”Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës/lotit, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”. Referuar parashikimeve ligjore të nenit 43, pika 2, germa c), për procedurat nën kufirin e ulët monetar, siç është rasti i kësaj procedure.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për vitin 2025 (Sipas QKB) si dhe këstet e maturuara për vitin 2026 sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT.

Ndersa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, duhet te dorezoje prane AK, dokumentat provuese per vetdeklarimet ne formularin permbledhes te vetdeklarimit,sic kerkohet ne piken 2.2.2, duke dorezuar dokumentacionin origjinal ose kopje te njesuara me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe ne ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr. 9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet qe ushtrojne aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit te kontrates, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht **120,481.67 (Njëqind e njëzet mijë e katërqind e tetëdhjetë e një pikë gjashtëdhjetë e shtatë) lekë.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore ku të shënohen datat, shumat dhe **shërbimeve** të realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi,

dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 "Kerkesat per kualifikim", te Ligjit Nr 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar pika 4 "ne lidhje me aftesite teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund te vendosin kërkesa qe garantojne se operatoret ekonomike zoterojne burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe pervojen e nevojshme per te zbatuar kontraten sipas nje standardi te pershtatshem cilesie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë qe operatoret ekonomike te kene nje nivel te mjaftueshem pervoje qe vertetohet nga referenca te pershtatshme nga kontrata e zbatuara ne te shkuaren" dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dështi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbime të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të shërbimit të kërkuar objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë realizuar kontrata të ngjashme, të jete afer limitit maksimal të lejuar dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikojnë në ecimin e punës së AK.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim të konkurrencës dhe është në masën 20% të fondit limit.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT) ku të përfshihen kategoritë:

5) Projektues vepra hidroteknike

5/c (projektim ujësjellës kanalizime urbane-rurale).

6) Projektues rrugë hekurudha

6/a (rrugë lokale rrugë urbane dytesore dhe rrugë interurbane dytesore).

8) Projektues gjeodet

8/a (Rilevime inxhinierike).

10) Projektim i impianteve te prodhimit dhe te shperndarjes se energjise

10/e (kabina elektrike te rrjetit shperndares-linja te tensionit te ulet ,te mesem)

11) Projektues te sinjalizimit rrugor

11/a (sinjalistike jo ndricuese ne rruge lokale, rruge urbane dytesore dhe rruge

Interurbane dytesore dhe sheshe e parkime)

Shënim: Në lidhje me vlefshmërinë e licencave ekzistuese dhe përshtatjen e kategorive me përshkrimet përkatëse, ofertuesit të mbajnë parasysh VKM-në Nr. 759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në Nr. 943, datë 28.12.2016.

(Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Autoritetit kompetent në Republikën e Shqipërisë, konform VKM-së Nr. 759, datë 12.11.2014, i ndryshuar me VKM-në Nr. 943, datë 28.12.2016).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e koaludit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente duke u bazuar ne kerkesat specifike te percaktuara ne termat e references.

Bazuar në objektivat e projektit dhe komponentët kryesorë të tij janë përcaktuar kategoritë e mësipërme të licensës së projektimit të Operatorit Ekonomik të cilat janë të domosdoshme për hartimin e projektit dhe përputhen me natyrën e shërbimit dhe sipas detyres se projektimit.

*Autoriteti Kontraktor per vendosjen e ketyre licensave eshte bazuar ne **Detyren e Projektimit**, , i cili do të përmbajë:*

Projektuesi duhet të ketë parasysh dhe të trajtojë: - Infrastrukturën rrugore - Sistemin kanalizimeve të ujërave të zeza - Sistemin kanalizimeve të ujërave të bardha - Rrjetin e ujësjellësit - Sistemin e ndriçimit rrugor - Rrjetin e furnizimit me energji elektrike dhe rrjetin e telekomunikacionit (nuk parashikohet ndërhyrje) - Rrjetin e sinjalistikë

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Licencat profesionale të stafit kryesor përgjegjës për zbatimin e kontratës në kategoritë si më poshtë shënuar, shoqëruar patjetër me CV dhe kontratat individuale të punës (të vlefshme):

5) Projektues vepra hidroteknike

5/c (projektim ujësjellës kanalizime urbane-rurale).

6) Projektues rrugë hekurudha

6/a (rrugë lokale rrugë urbane dytesore dhe rrugë interurbane dytesore).

8) Projektues gjeodet

8/a (Rilevime inxhinierike).

10) Projektim i impianteve të prodhimit dhe të shpërndarjes së energjisë

10/e (kabina elektrike të rrjetit shpërndarës-linja të tensionit të ulët ,të mesëm)

11) Projektues të sinjalizimit rrugor

11/a (sinjalistike jo ndricuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytesore dhe rrugë

Interurbane dytesore dhe sheshe të parkime)

- 1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 10 të DST. Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve ankimit ,duhet të dorëzojë pranë AK ,dokumentat provuese për vetdeklarimet në formularin përmbledhës të vetdeklarimit,sic kërkohet në pikën 2.3.3, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose kopje të njesuara me origjinalin.

Argumentimi: Këto kërkesa për stafin janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ”b” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Vendosja e këtij kriteri për stafin është bërë në përputhje me kërkesat e shprehura në termat e referencës

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

- **Inxhinier elektrik** nevojitet të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me gjendjen aktuale të ndricimit dhe projekti të jetë i realizuar që të arrijë standartin e kërkuar ku parashikohet vendosja e infrastrukturës për rrjetin energjisë elektrike, internetit dhe telefonisë në përputhje me standardin shqiptar.

- **Inxhinier ndërtimi**

I cili është i nevojshëm për hartimin e projektit të zbatimit dhe relacionit përkatës sipas përcaktimeve në detyrën e projektimit si dhe në mbështetje të pikës 1 të nenit 15 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e

rregullores së zhvillimit të territorit” e ndryshuar, në të cilin është parashikuar dokumentacioni për pajisje me leje ndërtimi.

- **Inxhinier topograf** konsiderohet i nevojshëm pasi projekti duhet të përmbajë të gjithë informacionin e rendesishëm topografik i cili nevojitet gjatë fazës së hartimit të projektit të zbatimit. Projekti duhet të përmbajë kuotat e rruges distancën e vendosjes së shtyllave etj. topografinë e gjendjes ekzistuese për zonën që zbatohet projekti në të cilën janë të azhurnuara të gjitha ndërtimet në gjendjen e sotme (me leje dhe pa leje) me Koordinata dhe përmasat përkatëse

- **Inxhinier hidroteknik**

Konsiderohet i nevojshëm pasi në detyrën e projektimit janë përcaktuar detyrat dhe qëllimi për realizimin e projektit të zbatimit ku përfshihet azhurnimi në terren i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza, ujësjellësit në mënyrë që të shmangen dëmtimet e mundshme të tij gjatë punimeve të tjera. Të projektohet rrjeti i KUB në varësi të reshjeve të zonës dhe të jepet zgjidhja optimale sipas manualit Teknik

- **1 (një)** punonjës të pajisur me certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis pasi për këtë objekt nevojitet hartimi i VNM prandaj kërkohej që në staf të jete një punonjës i certifikuar për hartimin e VNM.

2.3.4 Një punësim mesatar i të paktën **5 (pesë)** personave, për muajin e fundit të vërtetuar me;

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve
- b) Listpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për për muajin e fundit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 10 të DST.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetdeklarimet në formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sic kërkohej në pikën 2.3.4, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose kopje të njesuara me origjinalin.

Argumentimi: Këto kërkesa për stafin janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ”c” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është përlogaritur në për zbatimin me sukses të kësaj kontrate

Është kërkuar vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në pikën 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” sipas së cilës: ”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara

në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë: për përcaktimin e fuqisë punëtore minimale të kërkuar argumentojmë se jemi bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Termave të References. *Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë, tregon besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.*

2.3.5 Operatorët ekonomikë që paraqesin ofertë duhet të bazohen në njoftimin Nr. 5585 Prot., datë 25.07.2017 të Agjencisë së Prokurimit Publik, "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 354, datë 11.05.2016, 'Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim.'"

Mosrespektimi i bazës ligjore të sipërpërmendur në përgatitjen e ofertës përbën arsye për skualifikim, pasi oferta duhet të jetë brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar, sipas nenit 7/1 të VKM nr. 354, datë 11.05.2016, "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim."

Argumenti: Është vendosur kjo kërkesë bazuar në njoftimin me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjencisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (pika 1 e seksionit 2.2 të (Kapaciteti ekonomik dhe financiar) si dhe kapacitetet teknike (pika 1 seksionit 2.3 të Kapaciteti teknik), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku.

Argumentimi: Kjo kërkesë vjen mbështetur në përcaktimet e nenit 77, pika 3, të LPP, ku parashikohet: "...Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë", si dhe pikës 8, të nenit 42, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: "Autoriteti/enti kontraktor **mund** të përcaktojë kërkesat minimale që u kërkohen operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë".

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

❖ **Termet e Referencës janë hartuar në mbështetje të legjislacionit në fuqi në fushën e projektimit dhe ndërtimit, si më poshtë vijon:**

- Ligji Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar;
- Ligji Nr. 8402/1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar;
- VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 "Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", e ndryshuar;
- VKM Nr. 628, datë 15.07.2015 “Për Miratimin e Rregullave Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve”, si dhe të
- VKM Nr. 9, datë 11.01.2024 “Për miratimin e rregullave për projektet që duhet t’i nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste”.

Kërkesat teknike dhe produktet e pritshme të projektimit janë përcaktuar në përputhje me standardet dhe rregullat teknike në fuqi për projektimin e infrastrukturës rrugore, me qëllim garantimin e sigurisë rrugore, funksionalitetit të veprës, cilësisë së projektit dhe përputhshmërisë së tij me procedurat e oponencës teknike.